



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr 989/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit R... (...), me seli në Prishtinë, kundër debitorit “D.P.Z. T...”, të cilën e përfaqëson V.T, me seli Komuna e Lipjanit NRB, duke vendosur sipas parashtresës së debitorit për tërheqjen e prapësimit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr 172/2020 të datës 15.12.2020 të Përmbaremit Privat Arben Gashi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 26.10.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hudhet si i palejuar prapësimi i debitorit “D.P.Z. T...”, i paraqitur kundër urdhrit përmbaremore P.nr 172/2020 të datës 15.12.2020 të Përmbaremit Privat Arben Gashi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr 172/2020 i datës 15.12.2020 i lejuar nga Përmbaremi Privat Arben Gashi.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat Arben Gashi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit R... (...), ka caktuar urdhrin P.nr 172/2020 me datën 15.12.2020, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit – marrëveshjes mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Bisnes kredit kartelës të datës 21.09.2015 me të cilën është detyruar debitori “D.P.Z. T...”, që të paguaj borxhin në shumën prej 1,1150.23 €, me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesa që do të arrijnë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore në afat prej 7 ditëve me bllokimin e të gjitha llogarive nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të debitorit duke bërë pagesën me bartje të mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datën 28.12.2020 prapësim ka paraqitur debitori “D.P.Z. T...”, ndërsa me datën 31.12.2020 përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori.

Debitori me datën 31.08.2022, me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se e tërheq prapësimin e paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr 172/2020 pasi që ka arritur marrëveshje me kreditorin dhe i propozon gjykatës që lëndën ta dërgoj tek përmbaruesi privat pas tërheqjes së prapësimin.

Sipas nenit 67 par.1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje referuar si LPP) prapësimi përcaktohet si mjet i rregullt i goditjes dhe duke marrë parasysh faktin se me këtë ligj nuk është përcaktuar mënyra e vendosjes në rastet e tërheqjes së prapësimin nga e ana e debitorit dhe duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.”*, gjykata për vendosjen në rastin konkret zbatoi përshtatshmërisht dispozitat e LPK-së.

Në nenin 186 par. 3 të LPK-së, përcaktohet se *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës.*

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës së debitorit për tërheqjen e prapësimin të ushtruar me datën 28.12.2020 dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se prapësimi është i palejuar për shkak prapësimi është tërhequr nga ana e debitorit dhe në mbështetje të nenit 73. par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se *“ Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*, e ka hedhur prapësimin si të palejuar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par.3 të LPP-së dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 989/22, datë 26.10.2022.

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.